



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202003159/4

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e pikave 2, 5, 7 dhe 8 të Rregullores "Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës", miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018.*

KËSHILLIT BASHKIAK
Tiranë

Të nderuar,

Me shkresën nr. K2/I76-2 prot., datë 20.11.2020 ju kemi vënë në dijeni se institucioni i Avokatit të Popullit gjatë viteve të fundit ka marrë në shqyrtim disa ankesa dhe raste të filluara me iniciativë lidhur me të drejtën/lirinë kushtetuese të tubimit të shtetasve. Gjithashtu institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje nëpërmjet mediave protestat e qytetarëve të organizuara në qytete të ndryshme të vendit gjatë periudhës së pandemisë dhe të vendosjes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të përhapjes së infeksionit nga COVID-19.

Në përfundim të shqyrtimit të tyre, në disa raste është konstatuar se kjo e drejtë nuk respektohet gjithmonë nga organet e Policisë së Shtetit. Këto të fundit jo vetëm që nuk kanë kontribuar në realizimin e saj, por ndonjëherë janë bërë edhe pengesë duke e cenuar këtë të drejtë themelore kushtetuese të shtetasve. Për këto arsye në vijimësi janë bërë disa rekomandime organeve të Policisë së Shtetit.

E drejta e lirisë së tubimit paqësor mbron ato mënyra në të cilat njerëzit mblidhen së bashku në ambiente publike dhe të brendshme private.¹ Kjo e drejtë është njohur si një nga themelet e shoqërisë demokratike, tolerante dhe pluraliste, në të cilën individë dhe grupe me prejardhje

¹ *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019, fq.4, prg. 1, 2, 3.
[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

dhe besime të ndryshme mund të bashkëveprojnë në mënyrë paqësore me njëri-tjetrin. E drejta për lirinë e tubimit paqësor na mundëson t'u japim zë mendimeve të pakicave dhe për të bërë të dukshëm grupet e marginalizuara ose të papërfaqësuara.

Mbrojtja efektive e së drejtës për lirinë e tubimit paqësor mund të ndihmojë gjithashtu në nxitjen e një kulture të demokracisë së hapur, të mundësojë pjesëmarrje jo të dhunshme në çështjet publike dhe të forcojë dialogun për çështje me interes publik. Tubimet mund të ndihmojnë në sigurimin e përgjegjësisë së organeve publike dhe zyrtarëve qeveritarë dhe kështu të promovojnë qeverisjen e mirë në përputhje me sundimin e ligjit.

Legjislacioni i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut është jetik për përcaktimin dhe kufizimin e kompetencave dhe diskrecionit të autoriteteve publike dhe zyrtarëve të zbatimit të ligjit. Në thelbin e interpretimit të standardeve të të drejtave të njeriut qëndron parimi i përgjithshëm që të drejtat e njeriut do të gëzohen pa asnjë diskriminim.

Gjithashtu, autoritetet shtetërore përkatëse duhet të sigurojnë që publiku i gjerë të ketë qasje të lehtë dhe praktike në informacione të besueshme në lidhje me tubimet, me ligjet dhe rregulloret përkatëse, si dhe me procedurat, mënyrën e funksionimit të autoriteteve në lehtësimin e tyre.² Çdo vendim për të kufizuar ose ndaluar një tubim duhet të bazohet në legjislacionin që pasqyron standardet e zbatueshme dhe përshkruan qartë e në mënyrë transparente procedurat e vendimmarrjes. Çdokush që kërkon të ushtrojë të drejtën/lirinë e tubimit paqësor duhet të ketë mundësinë e përdorimit të një zgjidhje të shpejtë dhe efektive kundër vendimeve që pretendohen të jenë disproporcionale, arbitrare, kufizuese ose ndaluese në mënyrë të paligjshme të protestave.

Sjellim në vëmendje se liria e tubimeve është parashikuar dhe garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Pjesa e II-të “Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”, Kreu III “Liritë dhe të drejtat politike”, respektivisht në nenin 47 ku parashikohet se:

- “1. Liria e tubimeve paqësore dhe pa armë, si dhe e pjesëmarrjes në to është e garantuar.*
- 2. Tubimet paqësore në shesh dhe në vendet e kalimit publik bëhen sipas procedurave të parashikuara me ligj”.*

Liria e tubimit dhe e organizimit, garantohet edhe nga neni 11 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku shprehimisht thuhet se:

- “1. Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij.*

² Po aty, f.10, parag. 26.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

2. *Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të tjerëve....”.*

Sa i përket epërsisë së Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) në të drejtën tonë të brendshme, në nenet 17 dhe 122 të Kushtetutës parashikohet si vijon:

Neni 17

“1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.”

Neni 122

“1. Çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar përbën pjesë të sistemit të brendshëm juridik pasi botohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Ajo zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Ndryshimi, plotësimi dhe shfuqizimi i ligjeve të miratuara me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit për efekt të ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare bëhet me të njëjtën shumicë.

2. Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të.³

3. Normat e nxjerra prej një organizate ndërkombëtare kanë epërsi, në rast konflikti, mbi të drejtën e vendit, kur në marrëveshjen e ratifikuar nga Republika e Shqipërisë për pjesëmarrjen në atë organizatë, parashikohet shprehimisht zbatimi i drejtpërdrejtë i normave të nxjerra prej asaj.”

Ndërsa, rregullat procedurale që dispienojnë apo kushtëzojnë ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit janë të përcaktuara në mënyrë të shprehur në ligjin nr. 8773, datë 23.4.2001 “Për tubimet”, ku parashikohen edhe kufizimet apo ndalimet shteruese të cilat nuk mund të tejkalojnë në ushtrimin e saj. Ky ligj pasi përcakton se, çdo person ka të drejtë të organizojë dhe të marrë pjesë në një tubim paqësor dhe pa armë, parashikon gjithashtu se Policia e Shtetit garanton dhe mbron të drejtën e çdo personi për të organizuar e marrë pjesë në tubime paqësore dhe pa armë. Ndalimi dhe shpërndarja e një tubimi lejohet vetëm në rastet e parashikuara me ligj. Nga referimi në përmbajtjen e dispozitave të këtij ligji rezulton në mënyrë të qartë se, detyrat e Policisë së Shtetit në lidhje me tubimet janë:

Së pari, kryerja e veprime dhe marrja e masave të nevojshme për garantimin e ushtrimit të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve dhe mbarëvajtjen e tubimit;

³ KEDNJ-ja është ratifikuar nga shteti shqiptar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996.

Së dyti, ndalimi i ushtrimit të kësaj të lirie/të drejte bëhet vetëm për raste të kufizuara të cilat janë të përcaktuara në mënyrë qartë dhe shteruese në ligj. Ato nuk mund dhe nuk duhet të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ.

Për ushtrimin e kësaj të drejte kërkohet vetëm bërja e njoftimit në një kohë të përcaktuar i organeve të policisë ku të pasqyrohen disa të dhëna që lidhen me zbatimin e detyrës së saj si garantuese e ushtrimit të kësaj të drejte/lirie duke i dhënë kohe për të marrë masat e nevojshme për mbarëvajtjen e tubimit. Madje ligji aktual në nenin 7 parashikon edhe të drejtën e shtetasve për zhvillimin e tubimeve urgjente në rastet kur ka rrethana urgjente, i cili mund të zhvillohet pa respektuar afatin e parashikuar në nenin 5⁴ të këtij ligji, por detyrimisht duhet të bëhet njoftimi me shkrim i cili përmban elementët e përcaktuar në nenin 5, pika 2 të këtij ligji, si dhe arsyen e urgjencës. Në këto raste njoftimi duhet të bëhet menjëherë, po jo më vonë se 3 orë përpara kohës së zhvillimit të tubimit.

Fakti që në ligjin aktual përdoret termi njoftim drejtuar Komisarariatit të Policisë për zhvillimin tubimit dhe jo kërkesë është me shumë rëndësi dhe domethënës në favor të ushtrimit dhe garantimit të kësaj të drejte/lirie nga shtetasit. Nëse në këtë ligj do të parashikohej termi kërkesë për zhvillimin e tubimit, kuptohet në mënyrë të qartë se për të bërë të mundur ushtrimin e kësaj të drejte/lirie do të duhej miratimi i organit të policisë, sikurse ishte në ligjin e mëparshëm. Ndërsa përdorimi në ligj i termit njoftim, do të thotë që “vendimin” për ushtrimin e të drejtës e ka marrë vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi i organit të policisë. Pikërisht këtu qëndron ndryshimi thelbësor që ka sjellë ligji i vitit 2001 “Për tubimet”, për të garantuar ushtrimin real të kësaj të drejte/lirie themelore kushtetuese të shtetasve në një vend demokratik sikurse është edhe vendi ynë. Nëse njoftuesit nuk e bëjnë njoftimin me të dhënat e parashikuara dhe të kërkuara nga ligji, Shefi i Komisarariatit të Policisë ka të drejtën ligjore të komunikojë me organizatorin për plotësimin e të dhënave ose të marrë vendim të arsyetuar për ndalimin e tubimit në sheshe ose vendkalime publike, apo ndryshimin e vendit dhe të kohës së zhvillimit të tij. Është me rëndësi që të sjellim në vëmendje se fryma pozitive e ligjit aktual reflektohet në mënyrë të qartë edhe në nenin 12⁵ të tij, ku parashikohet zhvillimi i tubimeve në vendet e hapura për publikun pa bërë njoftimin paraprak të policisë sipas parashikimeve të nenit 5.

⁴ Në neni 5 të këtij ligji parashikohet se:

1. Në rast tubimi në sheshe ose vendkalime publike, organizatori dhe drejtuesi janë të detyruar **të njoftojnë** me shkrim shefin e komisarariatit të policisë jo më vonë se tri ditë para datës së zhvillimit të tubimit.

2. **Njoftimi** me shkrim duhet të përmbajë:

a) identitetin dhe adresën e drejtuesit dhe të organizatorit të tubimit;

b) qëllimin e tubimit;

c) datën, vendin, orën e fillimit dhe të përfundimit të tubimit dhe itinerarin e tij (nëse ka të tillë);

ç) numrin e përafërt të pjesëmarrësve dhe numrin e personave ndihmës në mbarëvajtjen e tubimit;

d) personat që do të flasin në tubim.

3. Në rast se njoftimi me shkrim nuk i përmban elementet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, ai i kthehet për plotësim organizatorit dhe drejtuesit të tubimit, të cilët duhet ta riparaqesin atë të plotësuar jo më vonë se 24 orë para kohës kur do të zhvillohet tubimi.

⁵ Në nenin 12 parashikohet se:

1. Tubimet në vende të hapura për publikun mbahen edhe pa njoftimin paraprak të policisë, sipas nenit 5 të këtij ligji.

Gjithashtu sqarojmë se fryma e ligjit “Për tubimet” është në përputhje edhe me Guidën e Komisionit të Venecias për të drejtën e tubimit. Sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut nuk është e nevojshme që legjislacioni i brendshëm të kërkojë njoftim paraprak të një tubimi, por njoftimi paraprak mund t'i mundësojë autoriteteve shtetërore të sigurojnë më mirë natyrën paqësore të tij dhe të vendosë rregullime për të lehtësuar mbledhjen e protestuesve ose për të mbrojtur rendin publik, sigurinë publike dhe të drejtat dhe liritë e të tjerëve. ***Përcaktimi i njoftimit nuk duhet të shndërrohet kurrë në një procedurë autorizimi de facto. Procedura për sigurimin e njoftimit paraprak për autoritetet publike nuk duhet të jetë e rëndë ose tepër burokratike.*** Për më tepër, korniza ligjore e brendshme duhet të sigurojë që protestat spontane mund të mbahen në mënyrë të ligjshme, dhe ligjet që rregullojnë lirinë e tubimit duhet të përjashtojnë në mënyrë të qartë kërkesat e njoftimit paraprak për to.⁶

Gjatë ndjekjes së kësaj problematike nga institucioni ynë, disa OJF në ankesat e paraqitura apo në tryezat e zhvilluara lidhur me ushtrimin e kësaj të drejte/lirie kushtetuese kanë ngritur shqetësimin e tyre për pengesat që krijon neni 61 i Vendimit të Këshillit Bashkak Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018 “Leja dhe procedurat e dhënies së lejes” (në vijim VKB nr. 130/2018) në realizimin e kësaj të drejte/lirie. Konkretisht, në pikën 2 të këtij neni parashikohet se:

“Subjekti që kërkon të zhvillojë aktivitete promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunare, manifestime politike në hapësirat publike të Bashkisë Tiranë duhet të pajiset me lejen përkatëse të lëshuar nga Bashkia Tiranë”.

Sipas ankuesve, kjo dispozitë është bërë pengesë për ushtrimin e të drejtës/lirisë së tubimit, pasi ka patur raste kur ndonëse organi i Policisë së Shtetit është njoftuar nga subjekti organizues për zhvillimin e tubimit, ndërkohë Bashkia e Tiranës nuk e ka miratuar lejen për zhvillimin e këtij aktiviteti.

Gjithashtu prej tyre është ngritur edhe shqetësimi lidhur me afatin e përcaktuar në pikat 5 dhe 7 të nenit 61 të VKB nr. 130/2018, ku parashikohet që *subjekti i interesuar duhet ta paraqesë kërkesën të paktën 25 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit dhe në rastet urgjente 7 ditë para.* Përveç sa më sipër, në pikën 8 të këtij neni parashikohet se *afati i shqyrtimit të kërkesës është 7 ditë nga data e marrjes së aplikimit.*

Për të bërë të mundur shqyrtimin e kësaj problematike i kërkuam Bashkisë Tiranë që të na dërgonit një informacion lidhur me arsyet dhe shkaqet ligjore të mos përputhjeve të parashtruara më sipër ndërmjet VKB Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018 me ligjin nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet” (në vijim ligji nr. 8773/2001).

2. Organizatorët e këtyre tubimeve mund të kërkojnë mbështetjen e policisë jashtë këtyre vendeve, për të mënjeluar ç'rregullimet gjatë ose pas zhvillimit të tubimit.

⁶ *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019, f.10, parag. 25.
[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

Drejtoria e Licencimit dhe Gjendjes Civile të Bashkisë Tiranë me shkresën nr. 41192/1 prot., datë 16.12.2020, ndërmjet të tjerave na informoi se Vendimi nr. 130, datë 15.11.2018 i Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, ka si objekt përcaktimin e kushteve dhe procedurave të detajuara për rregullat dhe kushtet e zënies/përdorimit të hapësirave publike në Bashkinë e Tiranës. Gjithashtu qëllimi i kësaj rregulloreje është të menaxhojë hapësirat publike dhe jo të ndalojë tubimet pasi këto të fundit gjejnë rregullim të posaçëm në ligjin nr. 8773/2001.

Në lidhje me shqetësimin e ngritur se neni 61 i VKB nr. 130/2018 bie në kundërshtim me realizimin e të drejtës së shtetasve për tubim u informuam se, parashikimet e nenit 61 të sipërpërmendur nuk kanë për qëllim dhënien e lejes për të ushtruar të drejtën kushtetuese të tubimit, por mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të të gjithë subjekteve që dëshirojnë të shfrytëzojnë hapësirën publike dhe zhvillimin e një aktiviteti. Kjo rregullore ka në thelbin e saj rregullimin e procesit të zënies së hapësirës publike nëpërmjet pajisjes me leje për përdorimin e hapësirës publike nëpërmjet pajisjes me leje për përdorimin e hapësirës publike nga subjekte që kërkojnë të zhvillojnë aktivitete promovuese, artistike dhe/ose kulturore, sportive, sociale dhe/ose komunitare apo manifestime politike në hapësirat publike të Bashkisë Tiranë, si dhe marrjes së masave në funksion të garantimit të të drejtave dhe detyrimeve që burojnë nga pajisja me këtë leje, të tilla si menaxhimi i kërkesave për shfrytëzimin e të njëjtës hapësirë publike, në të njëjtën kohë nga subjekte të ndryshëm, koordinimin për një devijim të mundshëm të trafikut rrugor, ndryshimin e itinerarit të linjave të transportit publik, etj.

Për sa i përket afateve të parashikuara në VKB nr. 130/2018, për depozitimin e kërkesave për leje për zënien e hapësirës publike për ushtrimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë akt, përcaktohen dy lloj afatesh, ato në kushte normale dhe ato urgjente. Ky përcaktim është bërë duke mbajtur në konsideratë vendosjen e një afati sa më të arsyeshëm, me qëllim kryerjen brenda një kohe të mjaftueshme të veprimeve procedurale edhe në raste të tilla të mundshme, në të cilat hapësira publike ku/kur do të zhvillohet tubimi, si sheshe, rrugë, bulevarde, trotuare, etj., e tëra apo një pjesë e saj, është tashmë e zënë nga një subjekt tjetër, i lejuar për të ushtruar një nga format e tjera të ligjshme të zënies së hapësirës publike.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se, nga praktikat që Bashkia e Tiranës ka trajtuar në raste urgjente mbi dhënien e lejes, kjo e fundit është lëshuar brenda 24 orëve nga dita e bërjes së kërkesës nga aplikanti, ashtu sikurse në asnjë rast, pajisja me leje për përdorimin e hapësirës publike për zhvillimin e manifestimeve politike e të tjera, nuk është refuzuar nga ana e Bashkisë Tiranë, duke mos cenuar kështu garantimin e të drejtës/lirisë për tubim.

Në mbyllje të kësaj shkrese theksohet se, qëllimi i VKB nr. 130/2018 është ngushtësisht i lidhur me menaxhimin e hapësirës publike dhe jo me shkeljen e të drejtës kushtetuese të organizimit të tubimeve paqësore. Bashkia Tiranë në çdo iniciativë të saj mban parasysh parimin e subsidiaritetit në thelb të të cilit qëndron qeverisja sa më pranë komunitetit, duke pasur parasysh rëndësinë dhe natyrën e detyrës, si dhe kërkesat e efijencës e të ekonomisë.

Në përfundim të shqyrtimit të kësaj problematike të rëndësishme dhe përgjigjes së dërguar nga Bashkia Tiranë të cilën e parashtruam më sipër vlerësojmë se pikat 2, 5, 7 dhe 8 të nenit 61 të VKB nr. 130/2018, e cila për zhvillimin e një aktiviteti të tillë *kërkon marrjen e lejes* nga Bashkia Tiranë, dhe detyrimin e subjektit të interesuar që *ta paraqesë kërkesën të paktën 25 ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit dhe në rastet urgjente 7 ditë para*, si dhe parashikimi i *afatit 7 ditë për shqyrtimin e kërkesës nga data e marrjes së aplikimit* vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me ligjin nr. 8773/2001 dhe parashikimet e nenit 11 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, sepse:

a) sikurse parashtruam më sipër ky ligj nuk parashikon që të bëhet kërkesë nga subjektet e interesuara për marrjen e lejes për tubim, por njoftim për zhvillimin e tij;

b) njoftimi për zhvillimin e tubimit bëhet në organet e Policisë së Shtetit dhe jo në bashki. Referuar nenit 6/2 të ligjit nr. 8773/2001 është detyrimi i Shefit të Komisarariatit të Policisë që të njoftojë me shkrim drejtuesin e pushtetit vendor dhe prefektin për zhvillimin e tubimit;

c) kjo mos përputhje ka sjellë si pasojë shqetësime të panevojshme ndaj subjekteve të interesuara dhe gjendje faktike të kundërligjshme. Evidentohet se, ndonëse organi i Policisë së Shtetit ka miratuar njoftimin e subjektit të caktuar për zhvillimin e tubimit, ndërkohë Bashkia e Tiranës nuk e ka miratuar ende lejen për zhvillimin e këtij aktiviteti, ndërkohë që data e zhvillimit të tij ka kaluar, duke cenuar në këtë mënyrë të drejtën/lirinë kushtetuesetë shtetasve për të tubuar.

ç) në ligjin “Për Tubimet” afatet e aplikimit dhe të shqyrtimit të njoftimit janë shumë më të shkurtra, të cilat fillojnë nga 3 orë për tubimet urgjente deri në 3 ditë për tubimet e tjera. Ndërsa afati i shqyrtimit të aplikimit është brenda 24 orëve nga paraqitja e njoftimit.

d) ndonëse në përgjigjen e ardhur nga Bashkia Tiranë, evidentohet dhe theksohet se nga ana e këtij institucioni janë trajtuar raste urgjente mbi dhënien e lejes dhe se kjo e fundit është lëshuar brenda 24 orëve nga dita e bërjes së kërkesës nga aplikanti, dhe se në asnjë rast, pajisja me leje për përdorimin e hapësirës publike për zhvillimin e manifestimeve politike e të tjera, nuk është refuzuar, ne mendojmë se edhe nëse është vepruar në këtë mënyrë, përmbajtja e kësaj dispozite krijon premisa për cenimin e të drejtës/lirisë kushtetuese të shtetasve për tubim dhe për këto arsye ajo duhet të ndryshohet dhe përmirësohet në afatet më të mira.

dh) kemi bindjen se kjo problematikë është krijuar për shkak se gjatë përgatitjes së Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, nuk është mbajtur në konsideratë ligjin nr. 8773/2001. Ky fakt provohet më së miri nga referimi i bazës ligjore në të cilën është mbështetur nxjerrja e kësaj Rregulloreje.

Pavarësisht se nga informacioni i dërguar nga Bashkia Tiranë nuk rezulton se ajo e konsideron veten si organ autorizues të tubimeve, por detyrimi i subjekteve kërkuese (organizatorët e tubimit) për t’u pajisur me leje për të përdorur ambientin publik cenon në thelb natyrën e kësaj

të drejte. E drejta e tubimit është e drejta e shprehjes së një qëndrimi politik, kulturor, etj. në publik e në mënyrë të organizuar.

Sqarojmë se VKB nr. 130/2018 është një akt normativ nënligjor. Aktet nënligjore nuk mund të vijnë në kundërshtim me aktet normative ligjore dhe nuk mund të kufizojë të drejtat e dhëna dhe të garantuara nga Kushtetuta, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti shqiptar dhe ligjet.

Për këto arsye, pikat 2, 5, 7 dhe 8 të nenit 61 të VKB nr. 130/2018 vijnë në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 17 të Kushtetutës dhe nenin 11 të KEDNJ ku parashikohet se, kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjestim me gjendjen që e ka diktuar atë. Këto kufizime nuk mund të çenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kufizimet e vendosura ndaj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut sikurse është dhe liria e tubimit nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në KEDNJ e interpretuar nëpërmjet Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke paravendosur si kusht që këto kufizime të jenë proporcionale me gjendjen që e ka shkaktuar nevojën për vendosjen e tyre. Shteti ka diskrecion për të konstatuar domosdoshmërinë e kufizimit të një apo disa të drejtave në përputhje me rrethanat që diktojnë këtë nevojë, duke mbajtur në vëmendje deri në ç' masë është e nevojshme të vijohet me kufizimet në përpjekje për të kapërcyer gjendjen e emergjencës⁷.

Për këto arsye, vlerësojmë se kjo dispozitë e Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018 është e paligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit 109 të Kodit të Procedurës Administrative⁸ dhe e bën aktin administrativ pjesërisht të paligjshëm. Duke iu referuar nenit 113 të këtij Kodi⁹, ajo duhet të ndryshohet dhe përmirësohet nga ana juaj, për të garantuar kështu, lirinë e tubimit.

⁷ Me notën verbale të Misionit Permanent të RSH pranë Këshillit të Evropës, të datës 31 Mars 2020, shteti shqiptar, në përputhje me nenin 15/3 të KEDNJ, i ka njoftuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Evropës derogimin nga disa të drejta të parashikuara nga nenet e Koventës, për shkak të gjendjes së epidemisë. Ndërkohë afati për të cilin është bërë derogimi ka rënë dhe aktualisht ai e ka humbur fuqinë ligjore.

⁸ Neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ”

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;*
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;*
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;*
- d) është në kundërshtim me ligjin material;*
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo*
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

⁹ Neni 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuara shprehimisht me ligj.

Këshilli Bashkiak Tiranë në përmbushje të misionit të tij ligjor ka të drejtën e vendimmarrjes për miratimin e akteve administrative në kuadër të mirëqeverisjes dhe rritjes së mirëqenies së banorëve të këtij qyteti. Por këto akte nuk duhet të cenojnë thelbin e të drejtave dhe lirive të shtetasve. Çmujmë se ushtrimi i të drejtës/lirisë së tubimit nuk mund t'i nënshtrohet kufizimeve të tjera përveç atyre të parashikuar në nenin 11/2 të KDENJ dhe në nenin 8 të ligjit të posaçëm "Për tubimet", të cilat janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare dhe sigurisë publike, për mbrojtjen rendit dhe parandalimin e kriminalitetit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave të tjerë.

Është rasti të sjellim në vëmendje detyrimet e shtetit që burojnë nga neni 15/2 i Kushtetutës ku parashikohet se, "*Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*". Në këtë kuadër, nga organet e pushtetit publik kërkohet që, jo vetëm të mos bëhen pengesë për ushtrimin e lirisë së tubimeve paqësore të shtetasve, por përkundrazi duhet të kontribuojnë për të lehtësuar dhe mbrojtur ushtrimin e së drejtës/lirisë së tubimit paqësor. Kjo detyrë duhet të pasqyrohet në kuadrin legjislativ, si dhe rregulloret dhe praktikrat përkatëse të zbatimit të ligjit.¹⁰

GJEDNJ në praktikën e saj ka konsideruar se njoftimi, dhe madje procedurat e autorizimit, për një ngjarje publike normalisht nuk shkelin mbi thelbin e së drejtës në bazë të nenit 11 të Konventës për sa kohë që qëllimi i procedurës është që të lejojë autoritetet të marrin masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për të garantuar zhvillimin normal të çdo tubimi, mbledhje apo grumbullimeve të tjera¹¹. Organizatorët e tubimeve publike duhet të veprojnë në përputhje me rregullat që rregullojnë këtë proces duke respektuar rregulloret në fuqi. Njoftimi paraprak i shërben jo vetëm qëllimit të bashkërendimit të të drejtës së tubimit me të drejtat dhe interesat e ligjshëm duke përfshirë lirinë e lëvizjes të të tjerëve, por gjithashtu qëllimit të parandalimit të trazirave apo krimit. Edhe në rastin kur nuk është bërë një lajmërim paraprak për protestë, ky element teknik nuk duhet të shkelë kurrsesi thelbin e së drejtës për ta ushtruar lirinë e tubimit.¹²

Ndërsa, Raporti i Zgjerimit i Bashkimit Evropian për Shqipërinë për vitin 2019, në kapitullin e të drejtave themelore parashikon shprehimisht se liria e tubimit dhe organizimit janë

2. *Anulimi i një akti administrativ ka pasojë për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasojë vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.*

3. *Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.*

¹⁰ *Guidelines on Freedom of Peaceful Assembly*, Doc. CDL-AD(2019)017, OSCE/ODIHR & Venice Commission, 8 July 2019.
[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)017-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)017-e)

¹¹ Shih, *Sergey Kuznetsov kundër Ruisë, nr. 10877/04, § 45, 23 tetor 2008.*

¹² Shih, *Éva Molnár kundër Hungarisë, 7 tetor 2008, kërkesa nr. 10346/05.*

shprehimisht të parashikuara në Kushtetutë dhe legjislacionin për tubimet dhe janë në përgjithësi në linjë me standardet ndërkombëtare si dhe me Rregullat Kuadër të ODHIR-it mbi të drejtën për tubime paqësore. Pavarësisht kësaj, ligji për tubimet nuk duket se adreson çështjen e tubimeve spontane dhe kundërprotestave. Gjatë periudhës së raportimit e drejta për tubime ishte përgjithësisht e garantuar, gjithsesi incidente u regjistruan në disa protesta dhe demonstrata politike.¹³

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në vijim të kryerjes së misionit kushtetues e ligjor në rolin e nxitësit të standardeve më të larta të të drejtave dhe lirive të njeriut në vend, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”; si dhe nenin 24/b të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur Avokati i Popullit vëren se është vetë përmbajtja e ligjit ose e akteve të tjera normative dhe jo zbatimi i tyre shkak që krijon premisa për shkelje të të drejtave të njeriut, të njohura nga Kushtetuta ose ligjet e tjera, ka të drejtë:

b. t’u propozojë organeve të administratës ndryshimin ose përmirësimin e akteve nënligjore; mosshqyrtimi i propozimit brenda 30 ditëve sjell si pasojë pezullimin e fuqisë së akteve nënligjore që shkaktojnë shkelje të të drejtave dhe lirive.”

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin dhe përmirësimin e pikave 2, 5, 7 dhe 8 të Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018.
2. Hartimi i dispozitave të reja të bëhet në përputhje me nenin 11 KEDNJ, nenin 17 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8773, datë 23.04.2001 “Për tubimet”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi lutemi të na njoftoni brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi

¹³ Progres Raporti i BE për Shqipërinë, f.10.

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

[Tel/Fax:+355 4 2380 300/315](tel:+35542380300315)
[E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100552/13

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për dhënien e diferencës së pagës të ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017, punonjësit të policisë A.C. si dhe të ish studentëve që kanë ndjekur studimet në ciklin e parë në Akademinë e Sigurisë për periudhën akademike 3-vjeçare 2017-2020.*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHTETIT
Tiranë

Për dijeni : Z. A.C.
Rr. "Sitki Çiço", Pall. 2K, Hyrja 13, në krah të "Big Market"

Tiranë

Me shkresën nr. K2/A11-2 prot., datë 16.04.2021 ju kemi vënë në dijeni se në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A.C., efektiv i Policisë së Shtetit, me detyrë Specialist Teknik në Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale për Mbështetjen Hetimore/Kërkimin, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale. Ankuesi shkruan se gjatë kohës që ishte në marrëdhënie pune me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Forcën e Posaçme Operacionale, ka lidhur një kontratë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të ndjekur Ciklin e Parë të studimeve në Akademinë e Sigurisë për një periudhë 3 vjeçare (kontrata Nr. 252/69 Prot., datë 07.11.2017). Në bazë të nenit 6, pika 3 të kësaj kontrate, për periudhën e studimeve ai duhet të trajtohej financiarisht sipas akteve normative në fuqi. Pavarësisht se në kontratë është përcaktuar që periudha e studimeve zgjat 3 vjet, në fakt çdo sezon shkollor ka zgjatur më pak se 6 muaj për çdo vit akademik dhe sipas VKM nr. 200, datë 15.03.2017, ai duhej të trajtohej duke iu referuar pikës 12/a të këtij vendimi, me pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të studimeve.

Ankuesi pretendon se nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është zbatuar në mënyrë jo të drejtë e korrekte VKM nr. 200, datë 15.03.2017, duke e konsideruar kohëzgjatjen e studimeve më shumë se 6 muaj dhe pas përfundimit të sezonit të parë të studimeve, për sezonin e dytë dhe të tretë, një periudhë kohe më pak se 12 muaj, e ka trajtuar këtë shtetas me 40 % të pagës mujore sipas pikës 12/b të kësaj VKM-je.

Sipas tij, në këto rrethana janë gjendur edhe kolegët e tij studentë, të cilët u janë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe kanë fituar të drejtën për të marrë diferencën e pagës që u është mbajtur padrejtësisht. Pavarësisht se ai nuk ka ndjekur rrugën gjyqësore, pas qëndrimit të mbajtur nga gjykata i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të përfituar në të njëjtën mënyrë si kolegët e tij, duke ia dhënë diferencën e pagës së mbajtur padrejtësisht pasi ndodhet në të njëjtat kushte me ta.

Drejtorja Juridike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit me shkresën nr. 384/1 prot., datë 25.03.2021 i ka kthyer përgjigje duke e informuar se vendimi gjyqësor nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë ka në cilësinë e palës paditëse 26 persona dhe ky vendim ka zgjidhur pasojat vetëm për këta punonjës policie. Për sa kohë që ai nuk ka qenë paditës në këtë proces nuk mund të pretendojë diferencën e pagës.

Ankuesi këtë përgjigje e vlerëson të padrejtë, sepse ai nuk e ka kërkuar diferencën e pagës së mbajtur në kundërshtim me ligjin në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të cituar më sipër. Ai i është referuar këtij vendimi për të provuar faktin se mbajtja e diferencës së pagës studentëve të Akademisë së Sigurisë është vlerësuar e kundërligjshme nga organet gjyqësore dhe ky vendim tashmë ka marrë formë të prerë. Ky precedent gjyqësor duhet të merrej në konsideratë nga strukturat e Policisë së Shtetit për të reaguar dhe për të korigjuar një shkelje të kryer prej tyre nga zbatimi jo korrekt i VKM Nr. 200, datë 15.03.2017.

Për të bërë të mundur shqyrtimin e ankesës së shtetasit A.C. ju kërkuam të na dërgonit një informacion lidhur me pyetjet si më poshtë:

1. Cili është qëndrimi juaj lidhur me pretendimet e ankuesit të parashtruara në ankesë?
2. Mbi bazën e cilit akt administrativ i është mbajtur atij diferenca e pagës në masën 60% atij për gjatë viteve të vazhdimit të shkollimit në Akademinë e Sigurisë?
3. Përderisa aktualisht ka disa vendime gjyqësore të formës së prerë lidhur me këtë problematikë, ku paditës kanë qenë kolegët e ankuesit, të cilët e kanë konsideruar të drejtë kërkesën e paditësve për t'i kthyer atyre diferencën e pagës së ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017, përse nuk i ktheni ankuesit diferencën e pagës së ndaluar padrejtësisht?

Në përgjigjen tuaj me shkresë nr. 197-A/2 prot., datë 27.04.2021 ndërmjet të tjerave na informuat se:

“Punonjësi i policisë z. A.C., aktualisht me detyrë Specialist, në Sektorin e Forcës së Posaçme Operacionale për Mbështetjen Hetimore/Kërkimin, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme

Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për periudhën Tetor 2017 - Qershor 2020, ka ndjekur studimet në ciklin e parë të studimeve të Arsimit të Lartë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë.

Nga Drejtoria e Forcës së Posaçme Operacionale pagesa e tij është bërë në zbatim të VKM nr. 200, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”.

Pavarësisht se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020 është shprehur për disa punonjës policie që kanë qenë palë në proces, ky vendim nuk përcakton detyrime për z. A.C., sepse ai nuk ka qenë palë në këtë proces gjyqësor.

Trajtimi financiar i ankuesit është bërë në zbatim të VKM nr. 200, datë 15.03.2017, i cili aktualisht është në fuqi.”

Për të kryer një hetim të plotë administrativ të kësaj ankese dhe të shqetësimit të ngritur nga ankuesi, por që cenon një numër të konsiderueshëm punonjësish policie, në vijim u kërkuam informacion Akademisë së Sigurisë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

Akademia e Sigurisë në përgjigjen e dërguar me shkresën nr. 856/1 prot., datë 09.07.2021 na informoi se, programi i studimit për “Sigurinë dhe hetimin”, në ciklin e parë “Bachelor”, zgjat tre vite akademike. Bazuar në urdhrin përkatës të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për fillimin e vitit akademik”, Akademia e Sigurisë miraton kalendarin akademik për shtrirjen e programit mësimor gjatë vitit akademik.

Gjithashtu u informuam për kohështrirjen e programit të studimit për çdo vit akademik për periudhën kohore 2017-2021 gjatë të cilës janë zhvilluar studimet në ciklin e parë të Arsimit të Lartë “Bachelor”, në Akademinë e Sigurisë, duke na u dërguar edhe tabela me të dhënat përkatëse.

Nga përmbajtja e kësaj tablele rezulton se kohëzgjatja e programit të studimit gjatë viteve 2017-2020, periudhë kur ankuesi ka vazhduar studimet ka qenë respektivisht, për vitin akademik 2017-2018 dhe vitin akademik 2018-2019 më pak se 6 muaj, ndërsa për vitin akademik 2019-2020 ka qenë 7 muaj e 6 ditë.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. 5262/1 prot., datë 27.05.2021, ndërmjet të tjerave na informoi se, në këtë gjykatë janë gjykuar 5 kërkesë padi të paraqitura nga 101 punonjës të Policisë së Shtetit me objekt “Detyrimin e palës së paditur të trajtojë financiarisht palët paditëse sipas pikës 12/a të VKM nr. 200/2017 për periudhat e studimit në Akademinë e Sigurisë. Nga këto, 2 prej padive janë pranuar, 2 janë rrëzuar dhe për 1 padi është vendosur pushimi i gjykimit për shkak të heqjes dorë nga paditësit meqënëse nga pala e paditur është ndryshuar mënyra e trajtimit të tyre financiar si rrjedhojë e miratimit të

VKM nr. 1046, datë 16.12.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 200, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe me shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”. Ky vendim ka marrë formë të prerë sepse nuk është ankimuar nga palët. Ndërsa për 4 vendimet e tjera është bërë ankim nga palët në proces në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Një nga këto çështje, për të cilën është pranuar padia nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1367, datë 19.04.2019, është gjykuar më tej në Gjykatën Administrative të Apelit në bazë të ankimit të bërë nga pala e paditur dhe personi i tretë, e cila me vendimin nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Ndërsa, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me shkresën nr. 521/1 prot., datë 28.05.2021, na informoi se, në këtë gjykatë janë regjistruar 5 çështje me 28 paditës punonjës të Policisë së Shtetit, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të trajtojë financiarisht palët paditëse sipas VKM nr. 200, datë 15.03.2017”. Gjykimi i këtyre çështjeve ka përfunduar nga të cilat, 4 me pranim të kërkesë padisë dhe 1 me rrëzim të saj. Për 3 nga këto çështje për të cilat gjykata ka pranuar kërkesë padinë është dhënë vendim pa të drejtë ankimi dhe konkretisht vendimet nr. 36, datë 28.01.2019; nr. 69, datë 12.02.2019; nr. 99, datë 27.02.2019, të cilat janë të formës së prerë, ndërsa për 2 të tjerat është bërë ankim në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

Sa i përket interesimit tonë në lidhje me çështjen në hetim, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me shkresën nr. 10/1 prot., datë 07.06.2021 në përgjigjen e saj na vuri në dijeni se, në këtë gjykatë janë regjistruar 30 çështje me palë të paditur Drejtoritë Vendore të Policisë në qarqe, me objekt “Detyrimin e palës së paditur të trajtojë financiarisht palët paditëse sipas pikës 12/a të VKM nr. 200/2017 për periudhat e studimit në Akademinë e Sigurisë”.

Nga çështjet e ardhura në këtë gjykatë ka përfunduar gjykimi për 5 prej tyre nga të cilat për 4 është lënë në fuqi vendimi i Gjykatave Administrative të Shkallëve të Para.

Një nga këto çështje është ajo me nr. 31140-02391-86-2019, me 26 paditës, për të cilën Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020 ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 1367, datë 19.04.2019 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.”* Kjo e fundit ndërmjet të tjerave ka vendosur: *“Detyrimin e palës së paditur të trajtojë financiarisht palët paditëse sipas pikës 12/a të VKM nr. 200, datë 15.03.2017 për sa kohë vazhdojnë studimet në ciklin e parë në Akademinë e Sigurisë duke iu dhënë pagën bazë mujore për gradën që kanë patur para fillimit të shkollimit. Detyrimin e palës së paditur të kthejë diferencat e pagës nga data 04.02.2019 e në vijim”*. Ndërsa për një çështje tjetër është vendosur prishja e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër dhe kthimi për rigjykim në të njëjtën gjykatë por me tjetër trup gjykues.

Nga shqyrtimi i ankesës si dhe analizimi i përgjigjeve të ardhura nga institucionet e përmenduar më sipër rezulton se, ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe ankuesit është lidhur një kontratë individuale me nr. 252/69 Prot., datë 07.11.2017 “Për ndjekjen e studimeve në ciklin e parë, në Akademinë e Sigurisë dhe detyrimin për të shërbyer për një periudhë të caktuar kohe në Policinë e Shtetit, pas përfundimit të studimeve”. Sipas

nenit 3 të kësaj kontrate, objekti i saj është rregullimi i të drejtave dhe detyrimeve gjatë ndjekjes së studimeve të ciklit të parë, në Akademinë e Sigurisë, miratuar me urdhrin e përbashkët nr. 7379/2, datë 05.10.2015 të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Ministrit të Arsimit dhe Sporteve nr. 7670, datë 06.10.2015 “Për hapjen e programit të studimeve të ciklit të parë “Për hetimin e krimit”, si dhe pas përfundimit të tyre.

Referuar nenit 4 të saj, “Kohëzgjatja e kontratës”, kjo kontratë është e vlefshme për periudhën e studimeve të ciklit të parë 3 (tre) vjet dhe kohën e qëndrimit në detyrë si punonjës policie jo më pak se 3 (tre) vjet, pas përfundimit të studimeve.

Ndërsa sipas nenit 6, pika 3 të kontratës, studenti/punonjësi i policisë përfiton trajtim ekonomik-financiar për të gjithë periudhën e studimeve, sipas akteve normative, të nxjerra për këtë qëllim.

Gjatë periudhës kohore të studimeve ankuesi është trajtuar në bazë të VKM nr. 200, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe me shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit”, respektivisht nenit 12 të saj¹⁴. Gjatë vitit të parë akademik 2017-2018 i cili ka filluar në datën 09.10.2017 - 31.03.2018, meqënëse periudha e studimit nuk i kalon 6 muaj, ai është trajtuar në bazë të pikës 12/a të kësaj VKM-je, duke përfituar pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit. Ndërsa gjatë vitit të dytë akademik 2018-2019 i cili ka filluar në datën 04.02.2019 - 31.07.2019, si dhe vitit të tretë akademik i cili ka filluar më 14.10.2019 - 20.05.2020, ai është trajtuar sipas pikës 12/b të kësaj VKM-je, duke përfituar 40% të pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të shkollimit.

Në vlerësimin tonë, trajtimi financiar i ankuesit gjatë vitit të dytë dhe të tretë akademik sipas pikës 12/b të VKM nr. 200/2017, duke i dhënë 40% të pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të shkollimit, është bërë në kundërshtim të plotë dhe të hapur me përmbajtjen e kësaj pike.

¹⁴ Në nenin 12 të VKM nr. 200, datë 15.03.2017, parashikohet si më poshtë vijon:

12. Punonjësit e Policisë së Shtetit mund të trajnohen brenda ose jashtë vendit, në kuadër të programeve të trajnimeve, të parashikuara e të organizuara nga institucioni. Gjatë kohës që kryejnë kurse shkollimi apo trajnimi, brenda apo jashtë vendit, me iniciativën e institucionit, përfitojnë trajtim me pagesë, sipas përcaktimeve të mëposhtme:

a) Për periudhat e shkollimit/trajnitimit që zgjasin nga një deri në gjashtë muaj, gjatë periudhës së shkollimit/trajnitimit punonjësi përfiton pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit;

b) Për periudhat e shkollimit/trajnitimit që zgjasin më shumë se gjashtë muaj, gjatë periudhës së shkollimit/trajnitimit duke filluar nga muaji i shtatë e në vazhdim, punonjësit i ndërpritet paga dhe i jepet një kompensim, në varësi të pjesëtarëve të familjes që ka në ngarkim:

- punonjësi pa ose me një pjesëtar të familjes në ngarkim, përfiton 40% të pagës bazë mujore për grade, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit;

- punonjësi me më shumë se një pjesëtar të familjes në ngarkim, përfiton 50% të pagës bazë mujore për grade, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit.

Në të gjitha rastet e përmendura më sipër, pagesat apo kompensimet e punonjësit kryhen nga njësia buxhetore ku është efektiv punonjësi, përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit.

Periudha e kohore e studimit gjatë vitit akademik 2018-2019 është e shkëputur nga periudha e kohore e studimit të vitit të parë akademik 2017- 2018. Ajo ka zgjatur 5 muaj e 27 ditë, pra nuk i ka kaluar 6 muaj dhe për rrjedhojë ankuesi duhet të trajtohej në bazë të pikës 12/a të kësaj VKM-je duke përfituar pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit dhe jo në bazë të pikës 12/b të saj, sikurse është bërë në fakt. Sqarojmë se në këtë përfundim ka arritur edhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 1367, datë 19.04.2019, i cili është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020 si dhe Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër me vendimet nr. 36, datë 28.01.2019; nr. 69, datë 12.02.2019; nr. 99, datë 27.02.2019, të cilat janë vendime të formës së prerë.

Po kështu edhe trajtimi financiar i ankuesit gjatë vitit të tretë akademik 2019-2020 sipas pikës 12/b të kësaj VKM-je, duke i dhënë 40% të pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të shkollimit është bërë në zbatim jo të drejtë e korrekt të këtij akti normativ. Nga llogaritjet e bëra rezulton se viti i tretë akademik ka filluar më 14.10.2019 - 20.05.2020. Pra, ky vit ka zgjatur 7 muaj e 6 ditë.

Sjellim në vëmendje përmbajtjen e pikës 12/b të VKM-së nr. 200/2017, e cila parashikon se: *“Për periudhat e shkollimit/trajnitimit që zgjasin më shumë se gjashtë muaj, gjatë periudhës së shkollimit/trajnitimit duke filluar nga muaji i shtatë e në vazhdim, punonjësit i ndërpritet paga dhe i jepet një kompensim, në varësi të pjesëtarëve të familjes që ka në ngarkim:*
- punonjësi pa ose me një pjesëtar të familjes në ngarkim, përfiton 40% të pagës bazë mujore për grade, që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnitimit;....”.

Nëse do të kuptohej e zbatohet drejtë kjo referencë ligjore, do të duhej që ankuesi për periudhën 6 mujore të vitit të tretë akademik të trajtohej me pagën bazë mujore për gradën që ka patur para fillimit të shkollimit sipas pikës 12/a të kësaj VKM-je. Ndërsa për periudhën tjetër kohore mbi 6 muaj, duke filluar nga muaji i 7 e në vijim, e cila është 1 muaj e 6 ditë duhej të trajtohej me 40% të pagës bazë sikurse parashikon pika 12/b e VKM-së.

Përgjigjja e kthyer nga ana juaj, të cilën e cituam më lart, çmojmë se nuk është korrekte dhe e bazuar në ligj. Sikurse parashtruam edhe më sipër nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit nuk është kuptuar dhe zbatuar në mënyrë të drejtë VKM nr. 200/2017. Shqetësues është edhe fakti se, ndonëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit janë bërë disa ankesa nga studentët/punonjësit e policisë, nuk është bërë deri më tani ndonjë reagim për të korigjuar veprimet e kundërligjshme të kryera nga strukturat vartëse të drejtorisë tuaj.

Ndërkohë konstatojmë se nga organi juaj nuk është reaguar edhe pasi organet gjyqësore kanë shqyrtuar disa kërkesë padi të bërë nga disa dhjetëra studentë/punonjës policie. Nga përgjigjet e ardhura nga disa gjykata në shkallë vendi ka rezultuar se pjesa më e madhe e kërkesë padive janë pranuar nga gjykatat të cilat, në vendimet e tyre kanë konstatuar se trajtimi financiar i studentëve/punonjësve të policisë është bërë në kundërshtim me VKM nr. 200/2017. Sqarojmë se nga informacioni që kemi aktualisht, rezulton se 7 nga këto vendime kanë marrë formë të

prerë dhe sipas akteve normative në fuqi janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga palët e paditura, konkretisht Drejtoritë Vendore të Policisë dhe strukturat e tjera të Policisë së Shtetit.

Pavarësisht se Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 86-2020-1063, datë 21.10.2020, ka pranuar kërkesën e 26 punonjësve të policisë për t'u trajtuar në bazë të nenit 12/a të VKM nr. 200/2017,3. dhe nuk përcakton detyrime për z. A.C., sepse ai nuk ka qenë palë në këtë proces gjyqësor, por ne vlerësojmë se ky është një precedent gjyqësor që duhej vlerësuar nga ana juaj. Nisur nga ky vendim, dhe që nuk është i vetëm me këtë objekt padie, nga organi juaj duhej të ishte bërë një ndërhyrje pranë strukturave vendore të Policisë së Shtetit për zbatimin me korrektesë të pikës 12 të VKM nr. 200/2017, si dhe korigjimin e shkeljeve të bëra duke u kthyer të dëmtuarëve (studentëve) diferencën e pagës së mbajtur padrejtësisht. Kthimi i diferencës së mbajtur mund dhe duhet të bëhet në rrugë administrative pa qenë e nevojshme që të dëmtuarit (studentët) t'i drejtohen organeve gjyqësore. Kjo mënyrë dhe rrugë reagimi do të ishte më efektive duke i kursyer buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit shpenzimet gjyqësore dhe ato përmbarimore nga zhvillimi i proceseve gjyqësore me paditës studentët/punonjësit e policisë si dhe vënia në ekzekutim i vendimeve gjyqësore.

Ndërkohë konstatojmë se edhe pjesa e përgjigjes së dërguar nga ana juaj se, *trajtimi financiar i ankuesit është bërë në zbatim të VKM nr. 200, datë 15.03.2017, i cili aktualisht është në fuqi*, nuk është e saktë dhe korrekte. Është i vërtetë fakti që ky akt nënligjor është ende në fuqi, por gjithashtu ai është ndryshuar me VKM nr. 1046, datë 16.12.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 200, datë 15.03.2017 "Për trajtimin me pagë dhe me shtesa mbi pagë të punonjësve të Policisë së Shtetit".¹⁵ Respektivisht pika 1/g e kësaj VKM-je ka ndryshuar pikën 12 të VKM nr. 200/2017, (pikë që është objekt i analizës tonë gjatë këtij hetimi administrativ) duke u bërë:

"12. Punonjësi i Policisë së Shtetit që shkollohet/trajnohet, brenda dhe jashtë vendit, në kuadër të programeve të trajnimeve, të parashikuara e të organizuara nga institucioni, gjatë periudhës së shkollimit/trajnimit, përfiton trajtim me pagesë në masën e pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit. Pagesa e punonjësit të policisë kryhet nga njësia buxhetore ku është efektiv punonjësi, përpara fillimit të kursit të shkollimit/trajnimit."

Ndonëse nuk kemi informacion se cili organ është iniciues për ndryshimin e bërë, por vlerësojmë se ky ndryshim dhe përmirësim i përmbajtjes së pikës 12 të VKM nr. 200/2017 nga Këshilli i Ministrave është një reagim pozitiv për respektimin e të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit. Përveç kësaj, kjo qasje e trajtimit financiar do të sjellë edhe një motivim më shumë për punonjësit e Policisë së Shtetit për të vazhduar shkollimin/trajnimin e tyre brenda dhe jashtë vendit sepse gjatë kësaj periudhe kohore të pakushtëzuar në afat nuk do të cenohen në pagë.

¹⁵ Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 223 të vitit 2020 në datën 21.12.2020.

Referuar nenit 109/d të Kodit të Procedurës Administrative¹⁶, vlerësojmë se aktet administrative (urdhrat) e nxjerrë nga njësia buxhetore ku është efektiv ish studenti A.C. për pagimin e tij në masën 40% të pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të shkollimit, si dhe nga njësiti buxhetore ku janë efektivë ish studentët e tjerë në Akademinë e Sigurisë gjatë periudhës kohore 2017-2020 bazuar në pikën 12/b të VKM nr. 200/2017, janë të paligjshme.

Sipas nenit 113/1 të Kodit të Procedurës Administrative¹⁷ një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj. Sa i përket afatit për anulimin dhe shfuqizimin, neni 117/2 i këtij Kodi, parashikon se anulimi ose shfuqizimi mund të bëhet brenda 30 ditëve nga dita kur organi publik është njohur me faktet që çojnë në anulimin ose shfuqizimin, por jo me vonë se 5 vjet nga njoftimi i aktit administrativ.

Ndërsa referuar nenit 118 parashikohet kthimi i pagesave dhe kontributeve në rastin e anulimit të një akti administrativ. Sipas pikës 1 të këtij neni, *të gjitha pagesat apo kontributet, të cilat tashmë janë paguar nga pala dhe/ose nga organi publik, në bazë të një akti të anuluar, duhet të kthehen*. Sipas pikës 2, *masa e kthimit të pagesave dhe kontributeve, e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, përcaktohet në aktin e anulimit dhe llogaritet nga organi publik, sipas dispozitave për begatimin pa shkak, në përputhje me legjislacionin civil*.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “c” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*, si dhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative të cituara më sipër,

¹⁶ Neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ”

Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:

- a) organi publik që e ka nxjerrë ka vepruar në mungesë të kompetencës;*
- b) është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative;*
- c) është në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ;*
- ç) është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas pikës 2, të nenit 4, të këtij Kodi;*
- d) është në kundërshtim me ligjin material;***
- dh) është rezultat i diskrecionit të ushtruar në mënyrë jo të ligjshme; apo*
- e) nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit.*

¹⁷ Neni 113 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit”

1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.

2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja për të shkuarën, ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm për të ardhmen. Anulimi dhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.

3. Anulimi ose shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë.

REKOMANDOJMË :

1. Marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror të Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale për të anuluar aktet administrative të nxjerra ndaj ish-studentit/punonjësit të policisë A.C. dhe dhënien e diferencës së pagës të ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017 për periudhën akademike 3-vjeçare 2017-2020 që ka ndjekur studimet në ciklin e parë në Akademinë e Sigurisë, respektivisht për vitin e dytë akademik 2018-2019 dhe për 6 mujorin e vitit të tretë akademik 2019-2020.

2. Marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror të Drejtorive Vendore të Policisë në qarqe dhe strukturave të tjera në vartësinë e organit tuaj për të anuluar aktet administrative të nxjerra ndaj ish-studentëve/punonjësve të policisë që kanë ndjekur studimet në ciklin e parë në Akademinë e Sigurisë gjatë periudhës akademike 3-vjeçare 2017-2020 dhe dhënien e diferencës së pagës të ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017, pavarësisht faktit që nuk kanë ngritur padi lidhur me cenimin e kësaj të drejte ligjore.

3. Përgjithësimin e këtij rasti dhe tërheqjen e vëmendjes strukturave përkatëse me qëllim zbatimin korrekt të akteve normative në fuqi që të mos përsëriten në të ardhmen shkelje të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Ermonela Ruspi



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202100013/9

Tiranë ___/___/2021

Lënda : *Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e vendimit nr. 182, datë 28.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrër.*

MINISTRIT TË BRENDSHËM
Tiranë

Për dijeni : Z. A.Gj.
Rr. "Ali Demi", Nd. 52, H. 1

Tiranë

I nderuar Zoti Ministër,

Në institucionin e Avokatit të Popullit ka bërë ankesë shtetasi A.Gj.. Ankuesi shkruan se është punonjës i Policisë së Shtetit, me gradën policore "Kryekomisar". Në vitin 2017 ai ka qenë me detyrë Shef i Komisarit të Policisë Gjirokastrër. Sipas tij, meqënëse e plotësonte kriteret ligjore për gradën policore "Drejtues", si kohën e qëndrimit në gradën "Kryekomisar", vlerësime pozitive në punë, si dhe për arsye të detyrës/funksionit që kryente, i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që t'i jepej grada policore "Drejtues", por kërkesa e tij është refuzuar.

Ndodhur në këto rrethana kur kërkesa e tij nuk është zgjidhur në rrugë administrative, ankuesi i është drejtuar me kërkesë padë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrër, me

objekt detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që t'i njohë gradën policore “Drejtues”.

Nga dokumentacioni i administruar nga ana jonë rezulton se gjykimi i kësaj çështjeje është bërë në prani të përfaqësuesit të palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje administrative, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr. 182, datë 28.03.2017 ka vendosur:

“1. Pranimin e kërkesë padisë.

2. Detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, t'i njohë paditësit gradën “Drejtues”....”

Ky vendim, fotokopjen e të cilit ankuesi na e ka dërguar së bashku me ankesën, ka marrë formë të prerë në datën 12.04.2017 pa u ankimuar.

Meqënëse vendimi i gjykatës i cituar më sipër, i cili është bazuar në aktet normative materiale respektivisht nenet 55 e 61 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 750, datë 16.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Policisë së Shtetit” dhe VKM nr. 917, datë 04.10.2013 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 803, datë 21.11.2007 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese për Gradat në Policinë e Shtetit dhe ekuivalentimin e tyre”, të ndryshuar, nuk u zbatua në mënyrë vullnetare nga pala e paditur, pra Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ankuesi i është drejtuar shërbimit përmbarrimor për të bërë ekzekutimin e tij, por nga ky institucion nuk është bërë asnjë reagim dhe vendimi deri më tani nuk është zbatuar ende.

Përveç sa më sipër ankuesi pretendon se, që kur ai ka fituar gradën “Drejtues” me vendim gjyqësor, në organikën e Policisë së Shtetit janë hapur 33 vende (funksione) të lira me gradën “Drejtues”, por ajo nuk i jepet. Për të provuar këtë fakt ai na ka dërguar edhe fotokopjen e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 871, datë 13.09.2018 “Për hapjen e procesit të konkurimit për fitimin e gradës policore “Komisar”, “Kryekomisar” dhe “Drejtues”.

Për shqyrtimin e kësaj ankese, i kërkuam Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit verifikimin e saj dhe dërgimin e një informacioni lidhur me pretendimet e parashtruara nga ankuesi.

Drejtorja e Përgjithshme e Policisë së Shtetit me shkresën nr. 520/1 prot., datë 26.01.2021, ndërmjet të tjerave na informoi se:

Punonjësi i policisë A.Gj. nga data 16.09.2016 deri në datën 09.05.2017, ka qenë në detyrën Shef Komisariati, në Komisariatit e Policisë Gjirokastër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër. Gjatë kësaj kohë shtetasi A.Gj. ka bërë kërkesë padi në gjykatë për njohjen e gradës policore “Kryekomisar”.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr. 67, datë 02.02.2016 ka vendosur njohjen e gradës policore “Kryekomisar”.

Më pas zoti A.Gj. duke qenë në të njëjtën detyrë, Shef Komisariati, në Komisariatin e Policisë Gjirokastër, në Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastër, ka kërkuar përsëri nga gjykata njohjen e gradës “Drejtues”. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër me vendimin nr. 182, datë 28.03.2017 i ka njohur gradën “Drejtues”.

Në bazë të vendimit nr. 892 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, funksioni i detyrës “Shef Komisariati”, kërkon gradën policore “Kryekomisar” dhe asnjëherë nuk ka kërkuar gradën policore “Drejtues”.

Referuar nenit 54 dhe nenit 61 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, VKM nr. 892, datë 21.12.2016 “Për përcaktimin e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit”, si dhe strukturës organike të miratuar me urdhër nr. 328/1, datë 02.05.2018, numri i funksioneve që korrespondojnë me gradën “Drejtues” është i limituar dhe vihen në dispozicion të punonjësve të cilët fitojnë këtë gradë nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurses dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimim/trajnitimit, duke u shoqëruar me efekte financiare.

Përveç sa më sipër në këtë shkresë u informuam se, **aktualisht Policia e Shtetit ndodhet në pamundësi objektive të zbatimit të vendimit gjyqësor të sipërcituar për shkak se nuk disponon funksione të lira për gradën policore përmes vendimeve gjyqësore.**

Pas shqyrtimit të kësaj ankese dhe të përgjigjes së dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit vlerësuam se ankesa e shtetasit A.Gj. është e drejtë dhe e bazuar në ligj. Atij i është shkelur e drejta e garantuar nga neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ku parashikohet e drejta për një proces të rregullt ligjor, si dhe dispozitat e Kodit Civil për të drejtën e përfitimit financiar nga rritja në gradë dhe për rrjedhojë edhe në funksion, për mbrojtjen e integritetit të tij, si dhe për vënien në ekzekutim të vendimeve gjyqësore.

Ka qenë e drejta e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në cilësinë e palës së paditur në gjykimin e kësaj çështjeje, që nëse nuk do të ishte dakord me vendimin nr. 182, datë 28.03.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, ta ankimonte atë në Gjykatën Administrative të Apelit, mjet të cilin nuk e ka ushtruar. Tashmë që ky vendim ka marrë formë të prerë, referuar akteve normative në fuqi, ai përbën titull ekzekutiv dhe duhet zbatuar. Asnjë organ shtetëror nuk mund të verë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, por duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Gjithashtu vlerësuam të rëndësishme t’ju sjellim në vëmendje se, nëse kjo drejtori nuk ka qenë dakord edhe me veprimet e përmbaruesit gjyqësor, ka patur të drejtën e ankimit në gjykatë,

brenda 5 ditëve nga kryerja e veprimit, për kundërshtim të veprimeve të përmbaruesit gjyqësor në bazë të nenit 610 të K.Pr.Civile. Nga përgjigjja e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk rezulton që ta ketë ushtruar këtë të drejtë ligjore, e cila duhet të ishte bërë objekt analize në këtë institucion.

Lidhur me këtë çështje ju sjellim në vëmendje edhe qëndrimin e mbajtur nga Gjykata e Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila në praktikën e saj të vazhdueshme ka theksuar se, *shteti duhet të marrë përsipër vazhdimisht detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në proces se do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë vendimin gjyqësor të formës së prerë dhe se e drejta për të pasur akses në gjykatë do të ishte iluzion nëse sistemi ligjor dhe zbatimimi i tij në praktikë do të bëhej shkak që një vendim gjyqësor i formës së prerë të mbetej jo efektiv dhe i pazbatueshëm për një kohë tepër të gjatë.*

Gjithashtu, edhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka një praktikë të gjerë e të pasur sa i përket trajtimit të problematikave për zbatimin e vendimeve gjyqësore. Ajo ka theksuar se, ... *parimet kushtetuese lidhur me procesin e rregullt ligjor, për të cilin bën fjalë neni 42/2 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të parashikuara në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pakufi për realizimin e saj”.*

Gjithashtu kjo Gjykatë ka deklaruar se, ...*ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre”.*

“Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj (neni 135, pika 1 i Kushtetutës). Gjykata ka konfirmuar më parë se gjykatat kanë të drejtën ekskluzive për dhënien e drejtësisë. Ky funksion i gjykatave përcakton vendin e gjyqësorit në sistemin e institucioneve të pushtetit shtetëror dhe statusin e gjyqtarëve (Shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 11, datë 02.04.2008). Asnjë pushtet tjetër nuk mund të funksionojë si gjykatë dhe të ushtrojë detyrën e gjyqtarit. Askush nuk mund të ndërhyjë në dhënien e drejtësisë apo në dhënien e vendimit për çështje të caktuara. Askujt nuk i lejohej të vërë në diskutim njohjen dhe vlerën e vendimeve apo të refuzojë zbatimin e tyre, pasi ato kanë marrë formë të prerë (Shih vendimet nr. 11, datë 27.5.2004 dhe nr. 20, datë 09.07.2009 të Gjykatës Kushtetuese).

Ndërsa në vendimin nr. 1, datë 19.01.2009, Gjykata shprehet se: *“Ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i një vendimi të formës së prerë të gjykatës duhet konsideruar si pjesë përbërëse e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në kuptim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (Vendimi nr. 27, datë 20.06.2007 i Gjykatës Kushtetuese). Ekzekutimi i vendimit përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë. Asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet*

të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre. (Shih vendimin nr. 6, datë 31.03.2006 të Gjykatës Kushtetuese).

Një tjetër vendim ku është trajtuar kjo çështje është edhe ai me nr. 75, datë 23.11.2017 i Gjykatës Kushtetuese, ku është theksuar se:

“... ekzekutimi brenda një afati të arsyeshëm i vendimit të formës së prerë të gjykatës është pjesë përbërëse e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Parimet kushtetuese të lidhura me procesin e rregullt ligjor, si dhe detyrimi për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës, nënvizojnë faktin se çdo qytetar, i cili i drejtohet një gjykate kompetente për realizimin e një të drejte, nuk mund të presë pa kufi për realizimin e saj. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përbën një element thelbësor të shtetit të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë dhe çdo organ shtetëror duhet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre (shih vendimin nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

Gjykimi për realizimin e një të drejte përbëhet nga dy faza, të cilat janë të lidhura pazgjidhshmërisht me njëra-tjetrën. Faza e parë, ose gjykimi në kuptimin e ngushtë, ka të bëjë me njohjen ose deklarin e së drejtës, që si rregull përfundon kur vendimi gjyqësor merr formë të prerë. Në fazën e dytë, kur nevojitet edhe ndërhyrja, qoftë edhe me masa shtrënguese, për zbatimin e vendimit gjyqësor, realizohet ai që quhet qëllimi i drejtësisë. Në këtë fazë e drejta është e sigurt, por kërkohet që ajo të vihet në jetë.

Ekzekutimi i vendimit të formës së prerë të gjykatës konsiderohet si faza përfundimtare e realizimit të një të drejte të fituar gjyqësisht. Vetëm pas realizimit të kësaj faze mund të konsiderohet se individi e ka vendosur plotësisht në vend të drejtën e tij të fituar. Pa dyshim që një vonesë në ekzekutimin e një vendimi mund të justifikohet në rrethana të veçanta, por ajo nuk mund të jetë deri në atë shkallë sa të dëmtojë thelbin e së drejtës (shih vendimin nr.79, datë 27.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese)”.

Nga qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në trajtimin e kësaj ankese, i cili vjen në kundërshtim të plotë e të hapur me ligjin dhe me vendimin gjyqësor, shtetasit A.Gj. i janë shkaktuar pasoja juridiko-civile, dëme pasurore e jo pasurore. Vazhdimi i kësaj gjendjeje të kundërligjshme, duke i cenuar ankuesit të drejtën për t’i dhënë gradën “Drejtues” dhe bërë emërimin në një funksion korrespondues me gradën “Drejtues”, i jep të drejtën ligjore atij që si subjekt i dëmtuar t’i drejtohet gjykatës me padi edhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në bazë të dispozitave të Kodit Civil. Kjo do të sjellë si pasojë rritjen e detyrimeve buxhetore për dëmin e shkaktuar dhe shpenzimet gjyqësore të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Ndërkohë ju bëjmë me dije edhe pasojat që rrjedhin nga ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”. Sipas nenit 1 të këtij ligji, organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet pasurore dhe jopasurore jashtëkontraktore, që u shkaktojnë personave fizikë a juridikë, privatë, vendas a të huaj. Ndërsa

në nenin 2 të tij jepet kuptimi dhe përkufizimi i përgjegjesisë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore". Sipas kësaj dispozite, *"Përgjegjësi jashtëkontraktore e organeve të administratës shtetërore"* kuptohet detyrimi i organeve të administratës shtetërore për të shpërblyer dëmin që këto të fundit i kanë shkaktuar interesave të personave privatë në ushtrim e sipër të funksioneve të tyre publike. Në nenin 3, gërma "a", të ligjit parashikohet një nga rastet kur organet e administratës shtetërore përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë privatë, kur kryejnë veprime a mosveprime të kundërligjshme. Ndërsa në nenin 4, paragrafi i dytë dhe i tretë, të ligjit është parashikuar përgjegjësia vetjake e punonjësve të organeve të administratës shtetërore, sipas të cilit:

"Punonjësit e organeve të administratës shtetërore, përjashtimisht, përgjigjen për dëmet që u shkaktajnë personave fizikë a juridikë privatë, kur vërtetohet se ata kanë vepruar me keqbesim. Në rastet e parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni, organi shtetëror punëdhënës, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërblimit që ka paguar".

Gjithashtu ligji i cituar më sipër, në nenet 1 dhe 8 të tij parashikon edhe dëmshpërblimin moral të atyre që dëmtohen nga organet e administratës shtetërore, i cili konkuron me dëmshpërblimin pasuror dhe me dëmshpërblimet e tjera jopasurore.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të drejtën ligjore të shkelur ankuesit, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike"* dhe në nenin 21/b, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 *"Për Avokatin e Popullit"*, në të cilin thuhet se: *"Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit..., paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive"*, me shkresën nr. K2/A1-3 prot., dsatë 26.02.2021, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit i rekomanduam:

"Marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 182, datë 28.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, i cili ka marrë formë të prerë në datën 12.04.2017, në favor të punonjësit të Policisë së Shtetit A.Gj. duke i dhënë gradën "Drejtues" dhe emërimin e tij në një funksion korrespondues të gradës "Drejtues"."

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me shkresën nr. 1475/2 prot., datë 21.05.2021 ndërmjet të tjerave na informoi se, në bazë të VKM nr. 892, datë 21.12.2016 *"Për përcaktimin e funksioneve korrespondeuese dhe kategorizimi për gradat në Policinë e Shtetit"*, si dhe strukturës organike të miratuar me urdhrin nr. 328/1, datë 02.05.2018, numri i funksioneve që korrespondojnë me gradën "Drejtues", është i limituar dhe vihen në dispozicion të punonjësve të cilët fitojnë këtë gradë nëpërmjet pjesëmarrjes në një proces aplikimi, verifikimi, vlerësimi konkurues dhe përfundimit me sukses të programit përkatës të arsimim/trajnitimit, duke u shoqëruar me efekte financiare.

Gjithashtu në këtë shkresë u informuam se, aktualisht Policia e Shtetit ndodhet në pamundësi objektive të zbatimit të vendimit gjyqësor të sipër cituar për shkak se nuk disponon funksione të lira për grada policore të fituara përmes vendimeve gjyqësore.

Nga përgjigjja e cituar më sipër rezulton se, vendimi gjyqësor në favor të punonjësit të policisë A.Gj. nuk zbatohet sepse Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk disponon funksione të lira për grada policore të fituara përmes vendimeve gjyqësore?!

Ky qëndrim jo vetëm që nuk përbën ndonjë arsye ligjore për mos zbatimin e vendimit gjyqësor të cituar më lart, por njëkohësisht tregon qartë për mos njohje të parimit kushtetues të ndarjes dhe balancimit të pushteteve të sanksionuar në nenin 7 të Kushtetutës, i cili parashikon se: ***“Sistemi i qeverisjes në Republikën e Shqipërisë bazohet në ndarjen dhe balancimin e pushteteve ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.”***

Sqarojmë se, në asnjë akt normativ ligjor apo nënligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet e përcaktohet ndonjë kontigjent i veçantë për përfshirjen në sistem të punonjësve në bazë të një vendimi gjyqësor. Por, ndërkohë në këto akte që rregullojnë marrëdhëniet e punës parashikohet e drejta e punëmarrësve që kur largohen padrejtësisht nga puna, t’i drejtohen me kërkesë padi organeve gjyqësore dhe kur nga këto të fundit vlerësohet dhe vendoset me vendim të formës së prerë kthimi në punë i punëmarrësve të larguar padrejtësisht, atëhere punëdhënësi është i detyruar që të zbatojë vendimet gjyqësore respektive.

Po kështu mund të themi edhe lidhur me dhënien e gradave policore punonjësve të Policisë së Shtetit. Referuar nenit 6/3 të ligjit nr. 2018/2014 “Për Policinë e Shtetit” në të cilin jepet përkufizimi i gradës policore, *“Grada policore” është shprehje e hierarkisë policore, emërtimi i çdo shkalle dhe shenja dalluese, shprehje e cilësive individuale, eksperiencës dhe përgjegjësisë në ushtrimin e funksioneve në Policinë e Shtetit, që fitohet nga punonjësi i policisë nëpërmjet një procesi konkurrues.*

Emërtimi i gradave, hierarkia e tyre, autoriteti përgjegjës për vlerësimin e përparimit të punonjësve të policisë në karrierë dhe dhënien e gradave (komisionet e gradimit), shpallja e fituesve për procesin e gradimit dhe kriteret përkatëse, verifikimi i kandidatëve dhe fazat e testimit të tyre, arsimimi e trajnimi i tyre, dhënia e gradës bëhet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, bazuar në aktin e vlerësimit të komisionit të gradës dhe e drejta e ankimit të kandidatëve rregullohen nga nenet 51-60 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe nga Rregullorja e Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, Kreu V, respektivisht nenet 161-173.

Në nenin 53/2 të ligjit nr. 108/2014 parashikohet se, grada "Nënkomisar" deri "Drejtues i parë" (në të cilën përfshihet edhe grada “Drejtues” që i është dhënë ankuesit nga gjykata) jepet nga Drejtori i Policisë së Shtetit për punonjësit, të cilët e fitojnë atë nëpërmjet procesit të konkurrimit, sipas këtij ligji. Ndërsa në nenin 60 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”¹⁸ dhe në nenin

¹⁸ Neni 60

171 të Rregullores së Policisë së Shtetit¹⁹ parashikohet procesi i ankimit. Pra në këto akte normative parashikohet edhe e drejta e ankimit të punonjësve të Policisë së Shtetit në çdo fazë të procesit për fitimin e gradës. Në rastin në fjalë, sikurse u parashtrua edhe më sipër meqënëse ankuesi A.Gj. nuk është shpallur fitues për gradën "Drejtues" në fazën e parë të aplikimit dhe ndërkohë nuk e ka fituar këtë të drejtë në rrugë administrative, ai ka ushtruar të drejtën ligjore të ankimit në gjykatën kompetente të parashikuar në Kodin e Procedurës Administrative. Në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje gjykata pasi ka vlerësuar se kërkesë padia e ngritur nga paditësi A.Gj. është e bazuar në ligj dhe në prova, ka vendosur pranimin e saj dhe detyrimin e palës së paditur, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, t'i njohë paditësit gradën policore "Drejtues".

Gjithashtu qëndrimi i mbajtur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit ndaj ankuesit duke mos zbatuar vendimin gjyqësor me justifikime të pa bazuara në ligj dhe të pa qënësishme, tregon në mënyrë të qartë se nuk njihet e zbatohet detyrimi kushtetues i organeve shtetërore për të ekzekutuar vendimet gjyqësore, i parashikuar në nenin 142/3 të Kushtetutës ku sanksionohet se: ***"Organet shtetërore janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore"***.

-
1. Punonjësi i policisë ka të drejtën e ankimit në komisionin e apelimit në çdo fazë të procesit për fitimin në gradë. Ushtrimi i së drejtës së ankimit brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren e Policisë pezullon nxjerrjen e urdhrin të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të komisionit të gradimit që është ankimuar.
 2. Komisioni i apelimit kryesohet nga Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të komisionit dhe afatet e ankimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.
 3. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të policisë duhet t'i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.
 4. Vendimi i komisionit të apelimit është i zbatueshëm menjëherë.
 5. Procedurat për fitimin e gradës nga momenti i shpalljes së procesit të konkurrimit deri në përfundim të procesit të ankimit përcaktohen në Rregulloren e Policisë.

¹⁹ Neni 171

Procesi i ankimit për fitimin e gradës

1. Punonjësi i Policisë ka të drejtën e ankimit, për çdo fazë të procesit për fitimin e gradës.
2. Ankimi bëhet me shkrim dhe i dërgohet Komisionit të Apelimit për fitimin e gradës, brenda 2 ditëve pune nga momenti i skualifikimit ose shpalljes së rezultateve të testimit.
3. Komisioni i Apelimit për fitimin e gradës, përbëhet nga Zëvendësdrejtori i Policisë së Shtetit, Drejtori i Burimeve Njerëzore, Drejtori i Standardeve Profesionale, si dhe dy punonjës të tjerë me gradën "Drejtues i parë".
4. Komisioni i Apelimit shqyrton ankesat dhe merr vendim brenda 5 ditëve pune, nga data e përfundimit të afatit të ankimit.
5. Ankuesit i kthehet përgjigje zyrtare me shkrim, brenda 3 ditëve pune, nga data e marrjes së vendimit nga komisioni.
6. Formularët e vlerësimit, fletët e testimit të plotësuar në mënyrë fizike ose elektronike, nuk i jepen aplikantit dhe nuk bëhen publike.
7. Ushtrimi i të drejtës së ankimit, brenda afatit të përcaktuar në këtë rregullore, pezullon nxjerrjen e urdhrin të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe efektet e aktit të vlerësimit të Komisionit të Gradimit që është ankimuar.
8. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës së aplikantit, nëse Komisioni e vlerëson të drejtë, ai njoftohet jo më vonë se dy ditë, para datës së fillimit të fazës pasardhëse të testimit.
9. Vendimi i Komisionit të Apelimit për fitimin e gradës është i zbatueshëm menjëherë.
10. Gjatë procesit të ankimit, punonjësit të Policisë i garantohet e drejta për t'u informuar, dëgjuar dhe mbrojtur, në përputhje me parimet e Kodit të Procedurave Administrative.

Theksojmë se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është pjesë e strukturave të organeve shtetërore dhe për rrjedhojë referuar nenit 142/3 të Kushtetutës ka detyrimin që të zbatojë vendimin gjyqësor në favor të shtetasit A.Gj.. Ky detyrim ka lindur menjëherë sapo ai ka marrë formë të prerë, pra që në datën 12.04.2017. Pra, pamundësia objektive në këtë rast nuk ka lindur nga mos parashikimi ligjor, por vjen nga interpretimi jo i drejtë e korrekt i ligjit.

Sikurse ka shprehur Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj, *asnjë organ shtetëror nuk mund të vërë në diskutim drejtësinë e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre*. Por në fakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në vend që të zbatohet ky vendim gjyqësor në mënyrë vullnetare, ai nuk po zbatohet ende edhe pas vënies në lëvizje nga ana e palës kreditore, të shërbimit përmbarimor.

Për sa më sipër, bazuar në pikën 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”* dhe në gërmën “c” të nenit 21 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror i organit që ka shkaktuar shkeljen”*,

REKOMANDOJMË :

Marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit për zbatimin e menjëhershëm të vendimit nr. 182, datë 28.03.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, i cili ka marrë formë të prerë në datën 12.04.2017, në favor të punonjësit të Policisë së Shtetit A.Gj. duke i dhënë gradën “Drejtues” dhe emërimin e tij në një funksion korrespondues të gradës “Drejtues”.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, lutemi të na ktheni përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh të parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

AVOKATI I POPULLIT

Erinda Ballanca